

Pogradec me 15/02/2022

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot më datë 15/02/2022, lidhet kjo kontratë dhurimi aksionesh ("Kontrata") ndërmjet palëve të mëposhtme (vecmas referuar si "Pala" dhe ne numrin shumësi si "Palet"):

DHURUESI:

1. **Z. Redi Buzo**, shtetas shqiptar, lindur në Pogradec, më date 04.12.1973, me numer identifikimi personal (NID) H31204060L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si "**Dhuruesi**");
2. **Z.Gentian Ramonllari**, shtetas shqiptar, lindur ne Korce me 13.05.1975, me numer identifikimi personal (NID) H 50513136H, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar (ne vijim referuar si "**Dhuruesi**")
3. **Sofokli Bardho**, shtetas shqiptar , lindur ne Bubullime, me 20.08.1967, me numer identifikimi personal (NID) G 70820026 P, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar (ne vijim referuar si "**Dhuruesi**")

PRANUESI I

DHURIMIT : Z.Niko Gavroi, shtetas amerikan, lindur në Korce, më date 22.10.1976, i identifikuar me pasaporte me nr. 658447079, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar si "**Pranuesi i dhurimit**")

Meqënëse :

Dhuruesi Z.Redi Buzo, është aksioner me të drejta te plota në shoqërinë PELIUM shpk (në vijim referuar si "Shoqëria"), NUIS L94010601H, me seli në Korce, Cerrave, Leshnice Zona kadastrale nr.2420, Pasuria nr. 108/167, dhe zotërues i një pjesëmarrjeje prej 33.34% të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga aksione të zakonshme (në vijim referuar si "Aksionet"), me vlerë nominale prej 33.340,00 Lekë , te cilat nuk janë te rënduar me barre apo kufizime të tjera në favor te të tretëve;

Dhuruesi Z.Gentian Ramonllari, është aksioner me të drejta te plota në shoqërinë PELIUM shpk (në vijim referuar si "Shoqëria"), NUIS L94010601H, me seli në Korce, Cerrave, Leshnice Zona kadastrale nr.2420, Pasuria nr. 108/167, dhe zotërues i një pjesëmarrjeje prej 33.33% të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga aksione të zakonshme (në vijim referuar si "Aksionet"), me vlerë nominale prej 33.330,00 Lekë , te cilat nuk janë te rënduar me barre apo kufizime të tjera në favor te të tretëve;

Dhuruesi Z.Sofokli Bardho, është aksioner me të drejta te plota në shoqërinë PELIUM shpk (në vijim referuar si "Shoqëria"), NUIS L94010601H, me seli në Korce, Cerrave, Leshnice Zona kadastrale nr.2420, Pasuria nr. 108/167, dhe zotërues i një pjesëmarrjeje prej 33.33% të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga aksione të zakonshme (në vijim referuar si "Aksionet"), me vlerë nominale prej 33.330,00 Lekë , te cilat nuk janë te rënduar me barre apo kufizime të tjera në favor te të tretëve;



Dhuruesët:

Dhuruesi Z.Redi Buzo, deshiron ti dhuroje 8.34 % te aksioneve te tij ,pa asnje kusht ose barre ligjore, pranuesit te dhurimit Z.Niko Gavroi.

Dhuruesi Z.Gentian Ramonllari, deshiron ti dhuroje 8.33 % te aksioneve te tij ,pa asnje kusht ose barre ligjore, pranuesit te dhurimit Z.Niko Gavroi.

Dhuruesi Z.Sofokli Bardho, deshiron ti dhuroje 8.33 % te aksioneve te tij ,pa asnje kusht ose barre ligjore, pranuesit te dhurimit Z.Niko Gavroi.

Në këto kushte, Palet bien dakord si më poshtë vijon:

1. Objekt i kësaj Kontrate është dhurimi pa asnjë kusht dhe kalimi ne favor të Pranuesit të Dhurimit të Aksioneve te dhuruesve me vleren totale nominale prej 25.000 leke qe perbejne 25% te kapitalin e Shoqërisë.
2. Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj kontrate nga Palët, Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar dhe zotërues me të drejta te plota i Aksioneve të dhuruara, sipas përcaktimit te nenit 1 më sipër, dhe Dhurueset zhvishen nga cdo e drejtë e detyrim në lidhje me aksionet e dhuruara.
3. Shperndarja perfundimtare e aksioneve pas aktit te dhurimit do te jete si me poshte:

a) Redi Buzo	25 % te aksioneve te kompanise
b) Gentian Ramonllari	25 % te aksioneve te kompanise
c) Sofokli Bardho	25 % te aksioneve te kompanise
d) Niko Gavroi	25 % te aksioneve te kompanise
4. Kjo Kontratë hyn në fuqi e prodhon efekte te plota me nënshkrimin e saj nga Palët, dhe përbën te gjithë marrëveshjen mes Palëve lidhur me objektin e saj.
5. Palët bien dakord qe kjo kontratë dhurimi do te zbatohet dhe interpretohet ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për cfare nuk parashikohet në këtë kontratë dhurimi do te zbatohen parashikimet e Kodit Civil te Republikës Së Shqipërisë mbi dhurimin.
6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, do të jetë kompetente për te zgjidhur mosmarreveshjet qe Palët nuk mund t' i zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
7. Kjo Kontrate dhe kalimi i Aksioneve nga Dhurueset tek Pranuesi i Dhurimit do te regiistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit (QKB) nga secila prej palëve.
8. Kjo Kontrate Dhurimi hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) faqe dhe ne 5 (pese) ekzemplarë te njëjtë ne gjuhen shqipe.

DHURUESËT:

PRANUESI I DHURIMIT:

Redi Buzo Gentian Ramonllari Sofokli Bardho

Niko Gavroi

